



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2694/2 prot

Datë 07.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-78603-08-29-2023, me objekt: “*Pyllëzime me Akacie*”, me fond limit 28,333,333 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
- Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Trade and Construction Group” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “A.M.E 2020” SHPK, me NIPT K83725201G dhe adresë: Ura e Gjolës, Nr. Pasurie 421/6, Zonë kadastrale 1299, Bubq, Durrës
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, me adresë: Rruga “Xhezmi Delli”, Godina nr.20, Tiranë
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “Trade and Construction Group” SHPK me NIPT M11320022Q dhe adresë: Rruga “Marko Boçari”, Pallati “TID”, Shkalla 1, Ap.3, Tiranë
- Operatori ekonomik “Kurora” SHPK me NIPT J76314803S dhe adresë: Lagja “Sporti”, Pallati i ri pranë Kishës Ortodokse, Gramsh

Operatori ekonomik “Albgarden” SHPK me NIPT K37513520N dhe adresë: Lagja “Skënderbeg”, godinë private 1 katëshe në superstradën Lezhë - Shkodër, Km 1, Lezhë

Në datën 06.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 2694/2023 protokolli, datë 06.11.2023 e operatorit ekonomik “A.M.E 2020” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-78603-08-29-2023, me objekt: “*Pyllëzime me Akacie*”, me fond limit 28,333,333 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 26.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Trade and Construction Group” SHPK, si dhe lënien të skualifikuar të operatorëve ekonomikë “Kurora” SHPK dhe “Albgarden” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK është skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

“Nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi për plotësimin e kësaj pike OE A.M.E Sh.p.k ka paraqitur 2 kontrata dhe 18 fatura tatimore të realizuara gjatë 3 viteve të fundit, konkretisht:

a) Kontrata me nr. 7275/8 prot., datë 13.11.2020 me objekt “Blerje pemë dekorative” lidhur me bashkinë Durrës në vlerën 8,200,000 leke pa tvsh. Nga shqyrtimi i preventivit të kësaj kontrate, rezulton se zerat që përmban ky preventiv, kanë të bëjnë me blerje malli (bimësi dekorative) dhe jo me punime në fushën pyjeve, objekt i kësaj procedure prokurimi. Për këtë arsye kjo kontratë nuk vlersohet si kontratë e ngjashme me objektin e këtij prokurimi.

b) Kontrata me nr. 590/10 prot., datë 02.07.2021 me objekt “Mirëmbajtje e ambienteve të brendshme dhe tarracës për OSHEE Grup Sh.a dhe për Drejtorin Rajonale Tiranë OSSH Sh.a”, lidhur me Drejtorinë Rajonale Tiranë/OSSH Sh.a, nuk vlersohet si kontratë e ngjashme për shkak se zerat e preventivit të kësaj kontrate lidhen me shërbime mirëmbajtje dhe jo me punime në fushën pyjeve, objekt i kësaj procedure prokurimi.

c) *Faturat tatimore të shitjes të realizuara në sektorin privat, përmbajnë zera e artikujve të llojit mall, respektivisht (a) lule, (b) kaktus, (c) fikus, (d) vazo, (dh) pleh ushqyes dhe nuk përmbajnë punime në fushën e pyjeve, objekt i kësaj procedure prokurimi. Për këtë arsye këto fatura tatimore nuk vlersohen si kontrata të ngjashme me objektin e këtij prokurimi.*”

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “A.M.E 2020” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Trade and Construction Group” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet).*

2.2.2 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

ose

Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39 pika 5, neni 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.4. *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 30 punonjës. Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet Vërtetimi nga Administrata Tatimore ku të tregohet numri i Punonjësve dhe Listë-pagesat për muajin e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.*

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues pretendon duke cituar “Lënien të skualifikuar të shoqërisë Kurora dhe Albgarden shpk për arsyet e konstatuara nga AK gjatë fazës së vlerësimit”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 07.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri